



3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 5103, datë 22.9.2023

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT
PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË TË
DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE,
GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE
AKADEMIKË, ME KARAKTER
USHTARAK, NË FUSHËN E MBROJTJES
DHE SIGURISË KOMBËTARE, TË
LËSHUARA NGA INSTITUCIONE TË
HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE
INSTITUCIONE TË TJERA TË
AUTORIZUARA**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 6, të nenit 92, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të shkronjës “P”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të pikës 17, të vendimit nr. 156, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe organizimin e funksionimit të saj”,

UDHËZOJMË:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të “Diplomave

profesionale/certifikatave profesionale”, diplomave “Bachelor”, diplomave “Master i shkencave”, “Master i arteve” dhe “Master profesional”, “Master ekzekutiv”, “Diploma të specializimit afatgjatë”, të fituara jashtë vendit, me karakter ushtarak, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë, si dhe legjislacionit specifik në këtë fushë, Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, është Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe ministria përgjegjëse për mbrojtjen/Akademia e Forcave të Armatosura.

2. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të gradave shkencore “Doktor”, me karakter ushtarak, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, si dhe për njohjen e titujve akademikë me karakter ushtarak, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, të fituar jashtë vendit, sipas legjislacionit për arsimin e lartë, si dhe legjislacionit specifik në këtë fushë, Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, është ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për mbrojtjen nëpërmjet komisioneve përkatëse. Sekretariati teknik për këtë shërbim ndodhet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

3. Njohja dhe njësimi, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes, ka për qëllim njohjen e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Republikën e Shqipërisë.

4. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm, kanë këto kuptime:

a) “Kualifikimi” është një rezultat formal i një procesi vlerësimi dhe vlefshmërie, i përfituar prej një organi kompetent/institucioni arsimor, me karakter ushtarak, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, të njohur/akredituar, që përcakton se individit ka arritur një nivel të caktuar njohurish, aftësish dhe kompetencash në përputhje me një standard të dhënë;



b) “Korniza Shqiptare e Kualifikimeve”, në vijim (KSHK), sipas përcaktimeve ligjore “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, është një sistem kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve, sipas një tërësie kriteresh, për nivele specifike të të nxënit të përfutur, që ka për qëllim integrimin dhe koordinimin e nënsistemeve kombëtare të kualifikimeve dhe përmirësimin e transparencës, aksesit, përparimit dhe cilësisë së kualifikimeve, që lidhen me tregun e punës dhe shoqërinë civile;

c) “Korniza Evropiane e Kualifikimeve”, në vijim (KEK), sipas përcaktimeve ligjore “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, është një kornizë, që përmban 8 nivele, të miratuara nga Parlamenti Evropian, për të ndihmuar vendet dhe sektorët të krahasojnë kualifikimet, të përmirësojnë njohjen e ndërsjellë dhe të nxisin lëvizjen gjeografike, si dhe të nxënit gjatë të gjithë jetës;

c) “Institucione të autorizuar” janë institucione kompetente, të cilat nuk janë institucione të arsimit të lartë, por lëshojnë diploma/certifikata profesionale, diploma të arsimit të lartë me karakter ushtarak, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare të vlefshme në vendin e origjinës, që vërtetojnë përfundimin e studimeve, konform kuadrit ligjor në fuqi të vendit përkatës;

d) “Rrjeti Evropian i Qendrave Kombëtare të Informacionit (ENIC-NARIC)” është një rrjet me qendra kombëtare, i ngritur për të mbështetur institucionet dhe qytetarët me njohjen e kualifikimeve akademike. QSHA-ja shërben si qendra kombëtare e rrjetit ENIC/NARIC për informimin dhe njohjen e diplomave për Republikën e Shqipërisë.

5. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë nuk shqyrton aplikimet për rastet, si më poshtë:

a) diploma/certifikata profesionale, diploma, grada shkencore, për programe studimi me karakter ushtarak, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, të ndjekura në Republikën e Shqipërisë;

b) diploma/certifikata profesionale, diploma, grada shkencore për programe studimi me karakter ushtarak, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare të hapura/licencuara, si programe studimi *online*/në distancë, për të cilat studimet janë ndjekur *online*/në distancë sipas përcaktimit të diplomës/suplementit/dokumentacionit zyrtar të lëshuar nga institucioni që ka lëshuar diplomën;

c) dokumente për programe studimi të papërfunduara, që nuk përmbushin kushtet për të qenë diploma/certifikata profesionale, diploma, grada shkencore, të niveleve 5, 6, 7 dhe 8, sipas përcaktimeve të legjislacionit të vendit të origjinës dhe legjislacionit shqiptar. Këto dokumente shqyrtohen nga institucioni i arsimit të lartë pranë të cilit aplikohet për transferim studimesh;

c) certifikata/dëshmi për kurse kualifikimi ose plotësuese, si gjuhë e huaj, kompjuter etj.

Për rastet e përmendura në këtë pikë të udhëzimit, aplikanti njoftohet zyrtarisht për mosshqyrtimin e aplikimit.

6. Kriteret që duhet të përmbushë diploma/certifikata profesionale dhe grada shkencore për t'u njohur dhe njësuar janë:

a) të jetë lëshuar nga institucione të licencuara, të njohura dhe/ose të akredituara të arsimit të lartë në vendin e origjinës;

b) programi i studimit, në përfundim të të cilit lëshohet diploma/certifikata profesionale apo diploma, të jetë i njohur/akredituar në datën e lëshimit të saj;

c) certifikata apo diploma të jetë e vlefshme në vendin e origjinës;

c) certifikata apo diploma të jetë autentike.

7. Informacioni paraprak mbi institucionet e arsimit të lartë që ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me standardet përkatëse të vendit të origjinës mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Rrjetit Evropian të Qendrave Kombëtare të Informacionit (ENIC-NARIC), ose në faqe të tjera zyrtare sipas fushës specifike. Në lidhje me dhënien e informacionit për të interesuarit për sistemin dhe institucionet e arsimit të lartë, si dhe kualifikimet me karakter ushtarak, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare të lëshuara prej tyre në Republikën e Shqipërisë, institucion përgjegjës është QSHA-ja.

KREU II

PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI

1. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, me karakter ushtarak, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, si dhe titujve akademikë me karakter ushtarak, në fushën e



mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, kryhet *online* nëpërmjet portalit *e-Albania*.

2. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar duhet të depozitohet detyrimisht në formatin elektronik gjatë aplikimit *online*, si dhe të dërgohet brenda 5 (pesë) ditëve nga data e aplikimit *online* edhe në rrugë postare sipas përcaktimeve të mëposhtme.

3. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve akademike që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare ose Evropiane të Kualifikimeve, përveç gradës shkencore “Doktor”, kryhet *online* sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet *online* në portalin *e-Albania*, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij;

b) aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) me ngjyra dokumentacionin e mëposhtëm:

i. diplomën/certifikatën profesionale, diplomën ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

ii. suplementin e diplomës dhe/ose listën e notave, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);

iv. mandatpagesën ose konfirmimin e pagesës *online*, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3.1 Në rrugë postare, pas kryerjes së aplikimit *online*, dërgohet në QSHA dokumentacioni i specifikuar në pikat 3/a, 3/b/i dhe 3/b/ii, të kreut II të këtij udhëzimi.

4. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore “Doktor” kryhet *online*, sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet *online* në portalin *e-Albania*, sipas shtojcës nr. 1;

b) aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) dokumentacionin e mëposhtëm:

i. diplomën dhe suplementin e saj (nëse ka të tillë), lëshuar nga institucioni përkatës i arsimit të lartë, që dëshmon fitimin e gradës shkencore “Doktor” ose dokumentin origjinal të barasvlershëm me diplomën, në rastet kur ky përbën

dokumentin zyrtar përkatës në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

ii. disertacionin e doktoratës. Në rast se disertacioni është në gjuhë të huaj, aplikanti paraqet një përmbledhje në gjuhën shqipe;

iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);

iv. mandatpagesën ose konfirmimin e pagesës *online*, sipas shtojcës nr. 2;

c) aplikanti duhet të depozitojë një kopje të disertacionit përkatës në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë (BKSH) dhe të paraqesë vërtetimin përkatës.

4.1 Në rrugë postare, pas kryerjes së aplikimit *online*, dërgohet në QSHA dokumentacioni i specifikuar në pikat 4/a, 4/b/i dhe 4/b/ii, të kreut II të këtij udhëzimi.

5. Institucioni përgjegjës, për njohjen në Republikën e Shqipërisë të titujve akademikë të fituar jashtë vendit, bazohet në kriteret dhe standardet shtetërore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në Republikën e Shqipërisë, për fitimin e titujve akademikë.

5.1 Aplikimi për njohjen e titujve akademikë kryhet *online* sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet *online* në portalin *e-Albania*, sipas shtojcës nr. 1;

b) aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) dokumentacionin e mëposhtëm:

i. dokumentin e fitimit të titullit akademik, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

ii. diplomën e studimeve pararendëse universitare, nëse kjo diplomë është fituar në Republikën e Shqipërisë ose kopje e doktoratës, e noterizuar, shoqëruar me vërtetimin e njohjes së gradës shkencore “Doktor” në Republikën e Shqipërisë, nëse studimet pararendëse janë ndjekur jashtë vendit;

iii. vërtetimin e regjistrimit të titullit akademik në bazën e të dhënave përkatëse në zbatim të kuadrit ligjor të vendit ku është fituar titulli akademik (nëse ky regjistrim është parashikuar nga legjislacioni përkatës i huaj);

iv. fotokopjen e kartës së identitetit apo pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);



v. mandatpagesën ose konfirmimin e pagesës *online*, sipas shtojcës nr. 2;

vi. deklaratën/skedën e nënshkruar në të cilin të jepet informacion për eksperiencën akademike në mësimdhënie; aktivitetin shkencor – lista e artikujve /botimeve shkencore, pjesëmarrje në simpoziume, konferenca, kongrese shkencore të shoqëruar me titujt e materialeve të paraqitura; si dhe botime të punimeve shkencore në organe shkencore ndërkombëtare. Informacioni i parashikuar në këtë skedë duhet të shoqërohet me dokumentacionin provues përkatës.

5.2 Në rrugë postare, pas kryerjes së aplikimit *online*, dërgohet në QSHA dokumentacioni i specifikuar në pikat 5/a dhe 5/b/i, të kreut II të këtij udhëzimi.

KREU III PROCEDURAT E NJOHJES DHE TË NJËSIMIT

1. Procedurat e njohjes dhe të njësimt, pas aplikimit *online*, të kualifikimeve akademike me karakter ushtarak, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare që i përkasin nivelit 5 deri në 8, përveç gradave shkencore “Doktor”, të Kornizës Shqiptare ose Evropiane të Kualifikimeve vijojnë me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit nga ana e Komisionit të Njohjes së Diplomave në QSHA. Kjo procedurë, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, përfundon brenda 45 ditëve.

1.1 Sektori i Njohjes së Diplomave të Arsimit të Lartë (SENJOD) në QSHA shërben si sekretariat teknik i Komisionit të Njohjes së Diplomave.

1.2 Aplikimi nuk konsiderohet i plotë nëse mungon një nga dokumentet e cituara në këtë udhëzim.

Informimi për plotësim dokumentacioni bëhet me postë elektronike. Procedura e njohjes dhe e njësimt fillon menjëherë pasi QSHA-së i është shfaqur aplikimi në platformën *e-Albania* në rastet kur dokumentacioni i ngarkuar në formë elektronike është i plotë sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

Brenda 3 (tri) ditëve nga fillimi i procedurës së njohjes dhe njësimt SENJOD kontakton me anë të postës elektronike me institucionin përgjegjës që ka lëshuar diplomën ose certifikatën përkatëse.

1.3 Në çdo rast, procedura e njohjes dhe njësimt nuk mund të përfundojë nëse aplikanti nuk paraqet

në formatin shkresor dokumentacionin e parashikuar në këtë udhëzim, në QSHA.

1.4 Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacion, SENJOD i kërkon aplikantit plotësimin e dokumentacionit me anë të platformës *e-Albania*, brenda 15 ditëve nga momenti i depozitimit të aplikimit. Në rast të mos depozitimit të plotësimeve brenda 30 ditëve, QSHA-ja ndërpret shqyrtimin e aplikimit dhe dokumentacioni arkivohet.

1.5 SENJOD-ja llogarit afatet e përcaktuara në këtë udhëzim për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve, duke iu referuar datës së plotësimit të praktikës me të gjithë dokumentacionin e plotë.

2. QSHA-ja, në zbatim të procedurës së verifikimit:

a) kërkon informacion nëse programi i studimit i përfunduar nga aplikanti, në një institucion të huaj të arsimit të lartë apo institucion tjetër të autorizuar, është i hapur/licencuar ose është ndjekur si program studimi *online*, ose *në distancë*;

b) kërkon çdo informacion shtesë që e konsideron të nevojshëm për vlerësimin objektiv për njohjen dhe njësimin e diplomës/certifikatës;

c) i kërkon, përmes postës elektronike, IAL-së përkatëse konfirmimin e autenticitetit, të paktën dy herë dhe në rast mospërgjigjeje, konfirmimi kërkohej me shkresë zyrtare (dërguar me postë zyrtare). Në rast se pas 1 viti nga momenti i kërkesës së konfirmimit me shkresë zyrtare, ende nuk ka një përgjigje nga IAL-ja, shqyrtimi i aplikimit përkatës ndërpritet dhe dokumentacioni arkivohet në QSHA. Aplikanti njoftohet për vendimin e komisionit mbi arkivimin e dokumentacionit.

Gjithashtu, konfirmimi kërkohej edhe me ndihmën e institucioneve të tjera, ose nga institucionet e tjera përgjegjëse sipas rastit;

ç) QSHA-ja i referohet listës zyrtare të institucioneve të njohura/licencuara/akredituara në vendin e origjinës, të publikuar në faqet përkatëse zyrtare të rrjetit ENIC-NARIC dhe sipas rastit kërkon informacion pranë qendrave të rrjetit evropian të informimit dhe njohjes së diplomave (ENIC-NARIC), dhe institucioneve përgjegjëse të shteteve të tjera mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë, vlefshmërinë e diplomave apo certifikatave, nivelin e tyre sipas kornizës kombëtare apo evropiane të kualifikimeve, si dhe informacion tjetër shtesë në funksion të njësimt të diplomës. QSHA-ja shërben si qendra kombëtare e rrjetit



ENIC/NARIC për informimin dhe njohjen e diplomave për Republikën e Shqipërisë;

d) materialet shkresore ose të printuara për të gjitha verifikimet e kryera, depozitohen në dosjen e aplikantit. Për verifikimet e kryera *online*, dokumentacioni i printuar firmoset nga nëpunësi që kryen verifikimet dhe depozitohet në dosjen e aplikantit.

3. Komisioni i Njohjes së Diplomave përbëhet nga tre anëtarë dhe drejtohet nga kryetari, i cili caktohet nga titullari i QSHA-së. Komisioni i Njohjes së Diplomave shqyrton, njeh dhe njëson kualifikimet akademike që i përkasin nivelit 5 deri në 8, përveç gradave shkencore “Doktor”, në bazë të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë duke respektuar dhe parashikimet e kuadrit ligjor shqiptar në fuqi.

4. Në zbatim të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në përcaktimet e shkronjës “b”, të nenit 75, të pikës 2, të nenit 124, të ligjit nr. 80/2015:

a) Diplomati e fituara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë, përpara aplikimit të sistemit të Bolonjës në Shqipëri, të cilat e kanë datën e lëshimit të diplomës deri në vitin 2010, me kohëzgjatje normale minimale 4 (katër) vite (tetë semestra), me kohë të plotë, të njësohen si ekuivalentët e tyre që ofroheshin në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në të njëjtën periudhë kohore, me përjashtim të diplomave të lëshuara në vendet ku programet “Bachelor” e kanë kohëzgjatjen zyrtare 4 vite akademike, pavarësisht datës së lëshimit të diplomës;

b) Diplomati e lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë, për programet e studimit të cilat përmbajnë të paktën 300 ECTS, me kohëzgjatje normale minimale 5 (pesë) vite akademike, të njësohen si ekuivalentët e tyre që ofrohen në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

5. Komisioni i Njohjes së Diplomave merr vendimin për njohje dhe njësim të certifikatës/diplomës ose mund të vendosë ta kthejë për plotësime të tjera të nevojshme të dokumentacionit të sekretaria teknike (SENJOD),

sipas këtij udhëzimi. Sekretaria teknike (SENJOD) zbardh procesverbalin dhe vendimin e Komisionit të Njohjes së Diplomave, i cili lëshon vërtetimin e njohjes dhe njësimit për çdo aplikant, nëpërmjet platformës *e-Albania* me nënshkrim dhe vulë elektronike, sipas formatit/shtojcës bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij. Në rastet kur ky komision nuk merr vendim për njohjen dhe njësimin e diplomës ose certifikatës, i kthen përgjigje të arsyetuar aplikantit nëpërmjet sistemit *online* për arsyet dhe mangësitë e aplikimit. Në rast se një aplikues aplikon për njohjen e dy ose më shumë diplomave që i përkasin niveleve të ndryshme, Komisioni i Njohjes së Diplomave procedon me njohjen e diplomës që i përket nivelit më të ulët dhe më pas procedon me njohjen e një diplome të një niveli më të lartë. Në ato raste kur diploma e nivelit më të ulët nuk njihet dhe njësohet, apo nuk trajtohet për shkaqet e parashikuara në pikën 5, të kreut I të këtij udhëzimi, komisioni nuk njeh dhe njëson diplomën e nivelit më të lartë.

6. Për njohjen e gradave shkencore “Doktor” në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë ngrihet, me urdhër të përbashkët midis ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për mbrojtjen, Komisioni i Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNJG), i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për mbrojtjen.

6.1 KNJG-ja përbëhet nga kryetarët si më sipër dhe nga një anëtar, për secilën prej fushave të studimit dhe kërkimit shkencor, pedagog i kategorisë “Profesor”.

6.2 Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA shërben si sekretariat teknik i KNJG-së.

6.3 KNJG-ja mblidhet periodikisht në varësi të numrit të aplikimeve. Procedura për shqyrtimin e dosjeve nga KNJG-ja fillon në momentin që SENJOD-ja në QSHA vlerëson se dosjet për njohjen e gradës shkencore “Doktor” janë të plota për shqyrtim sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

6.4 Në përfundim të procedurave të shqyrtimit, kryetarët dhe anëtarët e komisionit, nënshkruajnë procesverbalin dhe vendimin përkatës. Vërtetimi lëshohet nëpërmjet platformës *e-Albania* me nënshkrim dhe vulë elektronike të kryetarit, sipas shtojcës, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

6.5 Procedura e njohjes dhe njësimit të gradës shkencore të fituar jashtë vendit, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë



dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, përfundon brenda 45 ditëve.

6.6 Përcaktimet e pikave 1.2 dhe 1.3, të kreut III, të këtij udhëzimit, lidhur me afatet procedurale, aplikohen edhe për aplikimet për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore të fituara jashtë vendit.

7. Për njohjen e titujve akademikë ngrihen, me urdhër të përbashkët të ministrave përgjegjës për arsimin dhe mbrojtjen, komisione *ad-hoc*, për secilin aplikim për njohje titulli akademik të fituar jashtë vendit, me pedagogë ekspertë të fushës përkatëse të kategorisë “Profesor”. Komisionet *ad-hoc* për njohjen e titujve akademikë kryesohen nga ministri përgjegjës për arsimin dhe mbrojtjen dhe përbëhen nga kryetari, bashkëkryetarët dhe pesë anëtarë.

7.1 Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA shërben si sekretariat teknik i komisioneve *ad-hoc*.

7.2 Kërkesa për ngritjen e komisionit *ad-hoc* kryhet nga Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA, menjëherë pas depozitimit të aplikimit për njohjen e titullit akademik të fituar jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.

7.3 Në përfundim të procedurave të shqyrtimit dhe vlerësimit, kryetari dhe anëtarët e komisionit *ad-hoc* nënshkruajnë procesverbalin dhe vendimin përkatës. Nëse është vendosur njohja e titullit akademik, vërtetimi lëshohet nëpërmjet platformës *e-Albania* me nënshkrim dhe vulë elektronike të kryetarëve, sipas shtojcës, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

7.4 Procedura e njohjes së titullit akademik të fituar jashtë vendit, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, përfundon brenda 45 ditëve.

7.5 Përcaktimet e pikave 1.2 dhe 1.3, të kreut III të këtij udhëzimit, lidhur me afatet procedurale, aplikohen edhe për aplikimet për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore të fituara jashtë vendit.

8. Komisioni i Njohjes së Diplomave në QSHA, KNJG-ja dhe komisionet *ad-hoc*, për certifikata, diploma ose grada shkencore, si dhe tituj akademikë, interpretojnë dhe marrin vendim të argumentuar mbi njohjen ose jo, të mbështetur në legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, si edhe në praktikat më të mira të vendeve perëndimore.

9. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit, për diplomat që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ose Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (përveç gradave shkencore

“Doktor”), lëshohet i firmosur nga titullari i QSHA-së dhe kryetari i komisionit në dy kopje me nënshkrim dhe vulë elektronike (njëra kopje i bashkëngjitet vendimit përkatës të Komisionit të Njohjes së Diplomave dhe ruhet në dosjen e aplikimit përkatës).

10. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit të certifikatave/diplomave të nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ose Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, me përjashtim të gradave shkencore, përmban minimalisht elementet e mëposhtme:

- a) emrin, atësinë dhe mbiemrin e aplikantit;
- b) institucionin e huaj të arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën;
- c) shtetin përkatës;
- ç) numrin e krediteve ECTS (nëse mund të përcaktohet);
- d) emërtimin e plotë të programit të studimit;
- dh) formën e studimit;
- e) kohëzgjatjen e programit të studimit;
- ë) datën e lëshimit të diplomës;
- f) njohjen dhe njësimin e diplomës/certifikatës në Republikën e Shqipërisë.

11. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit të gradës shkencore “Doktor”, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij, përmban minimalisht elementet e mëposhtme:

- a) emrin, atësinë dhe mbiemrin e aplikantit;
- b) institucionin e huaj të arsimit të lartë që ka lëshuar gradën shkencore “Doktor”;
- c) shtetin përkatës;
- ç) datën e fitimit të gradës shkencore “Doktor”;
- d) fushën e studimit;
- dh) temën e disertacionit;
- e) numrin dhe datën e vendimit të KNJG-së;
- ë) numrin rendor të regjistrimit të gradës shkencore “Doktor” në regjistrin shtetëror të gradës shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit;
- f) njohjen dhe njësimin e gradës shkencore “Doktor” në Republikën e Shqipërisë.

12. Vërtetimi i njohjes së titujve akademikë, përmban minimalisht elementet e mëposhtme:

- a) emrin, atësinë dhe mbiemrin e aplikantit;
- b) institucionin e huaj të arsimit të lartë që ka lëshuar titullin akademik;
- c) emërtimin e titullit të fituar;
- ç) shtetin përkatës;
- d) datën e fitimit të titullit akademik;



dh) fushën e studimit;

e) numrin dhe datën e vendimit të komisionit *ad-hoc*;

ë) numrin rendor të regjistrimit të titullit akademik në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit.

13. QSHA-ja është institucioni përgjegjës për mbajtjen dhe plotësimin e regjistrit shtetëror të njohjes dhe njësimit të diplomave, dhe regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë. Regjistrat mbahen në formatin *hard copy* dhe në atë elektronik.

KREU IV TARIFAT

1. Tarifat për njohjen dhe njësimin e certifikatave/diplomave dhe gradave shkencore, që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, si dhe titujve akademikë, për çdo diplomë/titull akademik që kërkohet të njihet i referohen përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

2. PAGESA për njohjen dhe njësimin e certifikatave/diplomave dhe gradave shkencore, që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, si dhe titujve akademikë kryhet në llogarinë bankare të QSHA-së, të përcaktuar në faqen zyrtare të QSHA-së dhe *e-Albania*, në seksionin përkatës të njohjes së diplomave.

KREU V ANKIMIMI

1. Aplikanti për njohjen dhe njësimin e certifikatave dhe diplomave që i përkasin nivelit 5 deri në 8, përveç gradave shkencore “Doktor”, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve ka të drejtë të bëjë

ankim me shkrim kundër vendimit të Komisionit të Njohjes së Diplomave në QSHA, sipas afateve të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

2. Aplikanti për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore “Doktor” dhe titujve akademikë ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim kundër vendimit të KNJG-së ose komisionit *ad-hoc*, sipas afateve të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

3. Ankesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin mbi të cilin mbështeten pretendimet e ankuesit.

KREU VI DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

1. Për procedurën, afatet dhe dokumentacionin ndiqen përcaktimet e parashikuara në këtë udhëzim, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në marrëveshjet dy ose shumëpalëshe të nënshkruara ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin apo institucionit përgjegjës të autorizuar prej saj dhe një subjekti juridik të huaj, që kanë për objekt njohjen dhe njësimin e diplomave të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë.

2. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Akademia e Forcave të Armatosura, si dhe komisionet përkatëse.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Niko Peleshi

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu